



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Republika e Kosovës / Republika Kosova		
ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS		
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA		
VENDIMI ËSHTË I FORMËS SË PRERË		
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA		
Data Dana	15. 08 20 22	vit. god.
Punëtori i autorizuar Ovlašćeni radnik		

V.KD. Nr.6-8/22

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Bajram Lajqi - Kryetar, Agron Curri dhe Besian Sylja - antarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në zyrën Disiplinore të OAK-së, në çështjen disiplinore sipas propozimit 79-2/20 të dt.09.03.2022, të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, të plotësuar me Plotësimin e Propozimit të ZPD-së. me nr.79-4/2020 të dt.13.04.2022 kundër avokatit nga me adresë në

në bazë të nenit 51 paragrafi 1, nënparagrafi, 1.2. të Ligjit për Avokatinë, nr. 04/L-193, lidhur me nenin 123 paragrafi 3 të Statutit të OAK-së dhe neneve 35 e 36 të Rregullorës për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, pas mbajtjes së seancës jopublike të shqyrtimit kryesor disiplinor, me dt. 15.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

I paraqituri, nga Prishtina, me seli të zyrës në adresën në
, Rr.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

Me dt.06.10.2020, gjatë deklarimit të tij në emisionin "Prime Time" në televizionin Kanal 10, duke folur për gazetarin deklaroi, "e rrehi, e rrehi more e rrehi e qkoqi, e rrehi edhe mirë bile para hajdefinishen qesaj kamere" pastaj të njëjtin e ofendon duke e quajtur "aj far muti, aj far kondomi", ndersa pas kyqjes së gazetarit live në debat me videolidhje, në një moment pasi e ofendon, ky e shan me me fjalët "eu atë nanë" dhe "shko në tre pi*** te nanës", pastaj duke dalë nga studio e televizionit ju drejtohet të pranishëmve me fjalët "me kondoma mos em thirrni me folë".

Me çka, ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë, sepse me sjelljen dhe deklarimet e bëra ka vepruar në kundërshtim me aktet normative të OAK-së si dhe ka cenuar rëndë autoritetin dhe ka dëmtuar imazhin e avokatisë.

Andaj,

Kolegji Disiplinor i OAK-së, në pajtim me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Avokatinë, nenit 123 paragrafi 2 të Statutit të OAK-së, të paraqiturit, i shqipton masën disiplinore:

G J O B Ë

- I. Në shumën prej 5,000.00 € (pesëmijë) Euro.
- II. Obligohet i paraqituri av. _____, që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) Euro.
- III. Pagesa gjobës dhe paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Ar sy e t i m

Me dt.09.03.2022, Zyra e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, në Komisionin Disiplinor ka paraqitur propozimin disiplinor nr. 79-2/20, ndërsa me dt.13.04.2022, ka paraqitur Plotësimin e Propozimit 79-2/20, sipas aktvendimit të Kolegjit Disiplinor V.KD.Nr.6-1/2022 kundër të paraqiturit, av. _____ nga _____ me adresë në _____, rr. _____ me nr. të reg _____ të OAK-së, me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore kundër tij. Propozimi është bërë në bazë të fletëparaqitjes disiplinore të ushtruar nga z. _____ nga _____ me adresë Rr. _____ që mban numrin 79/20 e dt.15.10.2020.

Kolegji disiplinor, me dt.22.04.2022, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi shqyrtoi propozimin 79-2/2022 të dt.09.03.2022 dhe plotësimin e propozimit 79-2/2022 të dt.13.04.2022 të Prokurorit Disiplinor, me provat e bashkëngjitura, konstatoi se ekziston arsyeja bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____

Kolegji Disiplinor, mbajti seancën e shqyrtimit kryesor më datën 15.06.2022, në prezencën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, z. Rexhep Veseli, ushtruesit të fletëparaqitjes z. _____, e në mungesë të të paraqiturit av. _____ cili e kishte pranuar ftesën në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Kolegji Disiplinor pas verifikimit konstatoi se të paraqituri av. _____ nga shërbimi postar i Kosovës me dt.23.05.2022, është provuar ti dorëzohet ftesa, në zarf është shënuar arsyetimi “për naser”, pastaj me dt.24.05.2022, është shënuar arsyetimi “me raport”, me dt.02.06.2022, në zarf përseri është shënuar arsyetimi “për naser”, dhe në pjesën e përparme vula katrore me shënimin “nuk kërkoj”, ku nga konstatimet e nënpunësit të postës vërtetohet se të paraqiturit është tentuar t’i dorëzohet ftesa për seancë 3 herë dhe të njëjtit i është lënë njoftimi që të paraqitet në postë për ta marrë ftesën, por i njëjti nuk ka shkuar për ta marrë.

Pas kthimit të zarfit nga shërbimi postar, kolegji disiplinor përmes personit të autorizuar të OAK-së, me dt.03.06.2022, i ka dërguar ftesën të paraqiturit, ndërsa nga nënpunësi i OAK-së, është kthyer zarfi dhe fletëkthesa me arsyetimin “puntorët e zyrës deklarojnë se sot më vonë ose të hënën me dt.06.06.2022, mund ti dorëzohet zarfi _____”, me datën 06.06.2022 është kthyer fletëkthesa me arsyetimin “pranoj zyrtarja e zyrës së avokatit _____”.

Kolegji Disiplinor duke u mbështetur në dispozitën e nenit 53 të Ligjit të Avokatisë, lidhur me nenet 476, 477 dhe 478 të KPPRK-së, konstatoj se ftesa për seancë konsiderohet e dorëzuar dhe i paraqituri është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa i njëjti nuk prezanton në seancë dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, atëherë vendosi që seanca e shqyrtimit kryesor të mbahet në mungesë të të paraqiturit av. _____, pasi që për këtë janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 28 paragrafi 2 i Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë.

Kolegji Disiplinor i OAK-së, konform dispozitave të nenit 25, 29, 30,31, 33 dhe 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës kryesore dhe deklarimit të Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe ushtruesit të fletëparaqitjes se nuk kanë vërejtje në përbërjen e kolegjit disiplinor dhe procesmbajtëses, hapi seancën kryesore të shqyrtimit disiplinor me njoftimin e çështjes disiplinore sipas Propozimit të Prokurorit Disiplinor me nr. 79-2/20 të datës 09.03.2020.

Prokurori Disiplinor, z. Rexhep Veseli deklaroi: ZPD me dt.15.10.2020 ka pranuar fletëparaqitjen nga ushtruesi i sajë z. [] me pretendimet e shkeljes disiplinore ndaj av.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të ofruara ZPD me datën 09.10.2022 ka nxjerrë Propozim sepse: av. [] gjatë debatit të zhvilluar në Kanal 10 me datën 06.10.2020 ka fyer z.

[] me fjalët si p.sh. “ kondom, mut dhe në një moment e shanë më nënë” me fjalët “ eu atë nanë dhe shko në tre p... të nanës”, veprim ky në kundërshtim me nenin 119 të Statutit të OAK-së dhe nenin 8 të KEPA-së. Për këtë çështje ZPD ka dorëzuar provat konkrete duke përfshirë videon e emisionit.

Ushtruesi i fletëparaqitjes [] deklaroi: e mbështet në tërësi fjalën e Prokurorit Disiplinor dhe shton edhe disa momente ku a. [] e dëmton rëndë imazhin e profesionit të avokatit dhe të Odës së avokatëve të Kosovës. Gjatë këtij emisioni për të cilin Prokurori e tha fjalën e tij ai disa herë thotë se “ po ta kisha në studio [] e kisha rreh fizikisht”, disa herë e përsërit këtë thënie edhe gjatë lëshimit të studios dëgjohet edhe duke ma sharë nënën. Rastë të tilla kanë ndodhur edhe gjatë debatit televiziv ne RTK, emision – debat i udhëhequr nga [] ku në mënyrën më bizare e shanë edhe e fyer përfaqësuesin e []

[] Duke ja fyer nënën edhe motrën, dyjat. Rast tjetër [] e dëmton shumë rënd imazhin e OAK-së është sjellja e tij po ashtu publike në TV me fyrejen që ja bënj një aktiviste të njohur politike znj. [] Shembull tjetër po ashtu rast tejet i rëndë në TV T7 e fyen analistir [] duke i thënë “ e çka thu ti në qoftëse unë në këtë studio deklaroj se shefi yt nuk e pranon atësinë e djalit që e ka me një femër”. Para kolegjit kisha me shkru një libër me shkeljet flagrante që ky njeri i ka bërë nën petkun e avokatit dhe për mua personalisht është tepër e rëndë kur para vajzave të mija familjarëve të mijë më shahet nëna e cila është e zhdukur dhe sinqerisht kam menduar në bazë të përvojës sime 18 vjeqare edhe si përkthyes gjyqësor i shumë avokatëve dhe Gjykatave skandinave, shtrohet pyetja a do të mund ndonjë njëri ta ushtronte profesionin e avokatit?.

Kolegji disiplinor pas deklarimit të Prokurorit disiplinor dhe ushtruesit të fletëparaqitjes, konform nenit 30 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, vazhdoi me procedurën e administrimit të provave, me ç’rast u lexuan: Propozimi i ZPD-së nr. 79-2/2020 i datës 09.03.2022; Plotësim Propozimi i ZPD-së me nr.79-4/2020 të datës 13.04.2022; Njoftimi 79-1/2020, i pranuar personalisht nga i paraqituri me datën 04.04.2022; Emaili i datës 16.10.2020 i dërguar nga ushtruesi i fletëparaqitjes; Fletëparaqitja 79/20, e datës 15.10.2020 dhe u shiqua: CD me sekuenca të debatit të datës 06.10.2020 në TV kanal 10.

Kolegji disiplinor pas administrimit të provave të cilat kaluan pa vërejtje nga prokurori disiplinor dhe ushtruesi i fletëparaqitjes, konform nenit 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, i ftoj palët që të paraqesin fjalën përfundimtare.

Prokurori Disiplinor në deklaratën përmbyllëse deklaroi: Pas administrimit të provave, dëgjimit të ushtruesit të fletëparaqitjes, fatkeqësisht mungesës së të paraqiturit edhe pse të njëjtit i është dhënë mundësia edhe në Zyren e Prokurorit Disiplinor ta thotë fjalën e tij. U vërtetua që av. [] me datën 06.10.2020 në ambientet e kanalit 10 gjatë transmetimit live ka fyer z. [] dhe me këtë ka konsumuar shkelje të rëndë e paraparë me nenin 119 të Statutit të OAK-së dhe nenin 8 të KEPA-së. Gjithashtu ZPD i propozon Komisionit Disiplinor si rrethanë rënduese të kaluarën disiplinore të avokatit [], i cili brenda dy viteshit të fundit ka dënim të shqiptuar e të vërtetuar edhe nga Komisioni i Ankesave për shkelje disiplinore, andaj kërkojmë që ndaj të njëjtit të shqiptohet dënimi konform normativës së OAK-së për shkelje të rëndë.

Ushtruesi i fletëparaqitjes [] në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështes fjalën e Prokurorit Disiplinor dhe mbetem pranë asaj që kam deklaruar më parë.

Kolegji disiplinor nga provat e administruara vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Nga videoqinizimi në CD me sekuencat e emisionit "Prime Time" në Kanal 10 të dt.06.10.2020, gjatë deklarimit të të paraqiturit Av. [] pas pyetjes së panelistëve lidhur me një çështje mes tij dhe ushtruesit të fletëparaqitjes [], **u vërtetua fakti se i paraqituri**, ndër të tjera për ushtruesin e fletëparaqitjes deklaroi: "*e rrehi, e rrehi more e rrehi e qkoqi, e rrehi edhe mir bile para hajdefinisen qesaj kamere*" pastaj të njëjtin e ofendon duke e quajtur "*aj far muti, aj far kondomi*", ndersa pas kypjes së ushtruesit të fletëparaqitjes live në debat me videolidhje, në një moment pasi z. [] e ofendon, ky e shan me me fjalët "*eu atë nanë*" dhe "*shko në tre pi*** te nanës*", pastaj duke dalë nga studio e televizionit ju drejtohet të pranishmëve me fjalët "*me kondoma mos em thirrni me folë*".
- Nga deklarimi i ushtruesit të fletëparaqitjes u konfirmuan deklaramiet e të paraqiturit, ku disa herë thotë se e rrehi ushtruesin e fletëparaqitjes dhe sharjet e tij drejtuar të njëjtit.

Kolegji Disiplinor, pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit në tërësi të rrethanave të rastit, propozimit të Prokurorit Disiplinor, videoqinizimi në CD me sekuencat e emisionit "Prime Time" në Kanal 10 bashkëngjitur në shkresat e lëndës, deklarimit të ushtruesit të fletëparaqitjes dhe prokurorit disiplinor erdhi në përfundimin se përdorimi i shprehjeve dhe fjalëve "*e rrehi, e rrehi more e rrehi e qkoqi, e rrehi edhe mir bile para hajdefinisen qesaj kamere*", *aj far muti, aj far kondomi*", dhe sharjet "*eu atë nanë*" dhe "*shko në tre pi*** te nanës*", pastaj përseri fjala "*me kondoma mos em thirrni me folë*", nga i paraqituri Av. [] në media publike gjatë transmetimit të drejtëpërdrejtë, paraqet shkelje të nenit 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8, të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë, dhe se avokati [] është përgjegjës për këtë shkelje.

Deklarimet dhe shprehjet e të paraqiturit av. [] sipas nenit 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8, të Kodit të Etikës Profesionale për Avokat, Kolegji i konsideroi si shkelje të rëndë, pasi që me këto deklarimet dhe shprehjet e tilla i paraqituri, ka cenuar rëndë autoritetin dhe ka dëmtuar imazhin e avokatisë, dhe se kjo mënyrë e të shprehurit në media publike gjatë transmetimit të drejtëpërdrejtë, është në kundërshtim me dispozitat dhe frymën e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Fjalët, shprehjet dhe ofendimet e përdorura nga i paraqituri në media publike gjatë transmetimit të drejtëpërdrejtë në një televizion ku ka një shikueshmëri të konsiderueshme nga publiku i moshave të ndryshme, janë të pa pranueshme për një avokat profesionist, me pervojë dhe i cili ka njohuri të shumë të mira të Normativës dhe Kodit të Etikës për Avokat të OAK-së.

Kolegji vlerësoj në çfarëdo rrethane, madje edhe në rastet kur avokati mund të jetë i provokuar i njëjti do duhej të deshmonte kulturë të debatit të mbështetur në argumente, e jo të lëshohet në

perdorimin e fjalëve fyese dhe ofendimeve të ulëta siç ka bërë avokati
transmetimit të drejtpërdrejtë në emisionin Prime Time të Kanal 10.

gjatë

Megjithatë, kolegji vendosi që të paraqiturit t'i shqiptoi masën disiplinore gjobë, të paraparë për këtë shkelje në nenin 51 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Avokatinë Nr.04/L-193, lidhur me nenin 123 par.1 dhe 2 të Statutit të OAK-së dhe atë, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Kolegji në rastin konkret nuk gjeti rrethana lehtësuese. Ndërsa si rrethana rënduese Kolegji gjeti se i paraqituri, disa herë dhe në vazhdimësi gjatë deklarimit të tij përdor fjalë banale, ofenduese dhe nënqumuese, madje në një moment deklaroi se është fyerje e qëllimshme ndaj ushtruesit të fletëparaqitjes, si dhe faktin se i njëjti edhe më herët me vendimin e komisionit Disiplinor V.KD.Nr.3-4/2021 të formës së prerë, është shpallur përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, ku i është shqiptuar masa disiplinore gjobë.

Kolegji Disiplinor vlerësoi se me deklarta, shprehje banale dhe ofendime të ulëta siç ka bërë i paraqituri në këtë rast, cenohet rëndë autoriteti i avokatisë dhe dëmtohet tej mase imazhi i Odës së Avokatëve, andaj pasi që i shqyrtojë edhe masat tjera më të ashpra të parapara për shkelje të rënda, vendosi për këtë lloj dhe lartësi të masës, me bindjen se maksimumi i lartësisë së gjobës është masë adekuate dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masës disiplinore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës dhe paushallin disiplinor, Kolegji vendosi që i paraqituri të ngarkohet vetëm me paushallin, sepse shpenzime për ekspert, dëshmitarë dhe përkthyes nuk kishte.

Kolegji vendimi për paushallin, e mori në bazë të nenit 37 paragrafi 1, të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikantë.

Me bindjen e plotë se vendimi i Kolegjit në këtë çështje disiplinore është krejtësisht në përputhje me Ligjin e Avokatisë dhe normativën e Odës, me bindjen se për këtë çështje nuk mund të vendosej më mirë dhe më drejt se kështu, Kolegji vendosi ashtu si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. Nr.6-8/2022, dt.15.06.2022

Procesmbajtësja
Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryetar i Kolegjit Disiplinor
Av. Bajram Lajqi



KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.